

TRAINKOS SH.A.
TRAINKOS D.D.
TRAINKOS J.S.C.
Nr.No.Br. 2/32
Dt. 28.05.2019
Fushë Kosovë - Fushë Kosova - Kosava Prill


trainkos

HEKURUDHAT E KOSOVËS TRAINKOS SH. A.

2019

RAPORT TREMUJOR

Janar - Mars 2019



FUSHË KOSOVË,

Prill 2019

PËRMBAJTJA

I.	HYRJE	3
II.	STRUKTURA ORGANIZATIVE E HK – TRAINKOS SH. A	4
III.	TREGUESIT E RAPORTIT FINANCIAR	6
III. 1.	Gjendja financiare Janar – Mars 2019	6
III. 2.	Të hyrat	6
III. 3.	Shpenzimet	7
III. 4.	Të hyrat dhe shpenzimet operative për periudhën Janar – Mars 2019	8
III. 5.	Gjendja në para të gatshme – Raporti sipas bankës (31.03.2019)	10
III. 6.	Transaksionet e realizuara Janar – Mars 2019	11
III. 7.	Bilanci i gjendjes	11
IV.	DEPARTAMENTI I TRANSPORTIT TË UDHËTARËVE	12
IV. 1.	Pasqyra e performancës operative	12
IV. 2.	Organizimi dhe realizimi i transportit të udhëtarëve	12
IV. 3.	Numri i trenave, tren kilometër (T/km) dhe udhëtarë kilometër (U/km)	13
IV. 4.	Vonesa e trenave të udhëtarëve	13
V.	DEPARTAMENTI I TRANSPORTIT TË MALLRAVE	14
V.1.	Pasqyra e performancës në transportin e mallrave	14
V.2.	Shfrytëzimi i trenave	15
V.3.	Neto Ton & Neto Ton kilometër të transportuar	15
V.4.	Mallrat e transportuara	16
VI.	ZYRA E MIRËMBAJTJES E MJETEVE LËVIZËSE – MML	17
VI.1.	Pasqyra e performancës operative	17
VI.2.	Spektori i mirëmbajtjes	17
VI.3.	Faturimi për riparimin e vagonëve të huaj për periudhën Janar – Mars 2019	17
VII.	PROJEKTET KAPITALE	18
VIII.	KONTESTET GJYQËSORE	19
VIII.1.	Rreziqet nga kontestet gjyqësore për vitin 2019.....	19
IX.	DEPARTAMENTI I ZHVILLIMIT TË BIZNESIT	21
IX.1.	Planifikimi dhe zhvillimi i biznesit	21
IX.2.	Koordinimi i proceseve me ARH-në dhe institucionet tjera	22
IX.3.	Aktivitetet e marketingut	22
IX.4.	Raportimi i rregullt vjetor në Asociacionet tjera Hekurudhore	23
X.	SFIDAT KRYESORE GJATË PERIUDHËS JANAR – MARS DHE VEPRIMET PËR TË ARDHMEN	24

I. HYRJE

Raporti për periudhën Janar - Mars për vitin 2019, për HK - Trainkos SH. A. është karakterizuar kryesisht më përpjekjen e të gjitha niveleve organizative të kompanisë duke filluar nga Bordi i Drejtorëve, Menaxhmenti e deri te stafi ekzekutiv për arritjen e rezultateve më pozitive në kushtet dhe mundësitë ekzistuese.


Ky raport paraqet qartë aktivitetet gjatë këtij tremujori në funksion të arritjes së objektivave të vendosura me Planin e Biznesit. Po ashtu ky raport pasqyron vështirësitë dhe sfidat gjatë zhvillimit të aktivitetit të kompanisë për këtë tremujor, sfida këto që përcillen nga vitet paraprake e që ndikojnë drejtpërdrejt në mos arritjen e planifikimeve.

Sfidat për këtë periudhë kanë qenë nga më të ndryshmet, duke u përballur me të gjitha vështirësitë që vijnë si rezultat i mungesës së kërkesës në treg, veçanërisht atyre të mallrave dhe në anën tjetër me një konkurrencë të egër nga operatorë të transportit rrugorë të mallrave.

Po ashtu, sfida në vete mbetet edhe mos realizimi i planifikimit të deklaruar nga klienti ynë kryesor “NewCo Feronikeli” në transportin e mallrave, i cili për një periudhe kohore kishte vështirësi në operim.

II. STRUKTURA ORGANIZATIVE E HK – TRAINKOS SH. A.

Hekurudhat e Kosovës Trainkos Sh. A. brenda periudhës tremujore (01.01.2019 - 31.03.2019), në strukturën Organizative ka pasur disa ndryshime.



Hekurudhat e Kosovës -Trainkos SH. A. brenda periudhës tremujore Janar – Mars 2019 në numrin e përgjithshëm të të punësuarve ka pasur disa ndryshime të cilat kanë reflektuar edhe në përqindjen e strukturës së përgjithshme të të punësuarve. Në tabelën në vijim do të paraqesim gjendjen e të punësuarve në Kompani nga data 01.01.2019 deri më 31.03.2019, duke filluar nga numri i përgjithshëm i të punësuarve, moshë mesatare, punëtorët me kontrata të afatizuara dhe të paafatizuara etj.

Paraqitja statistikore për llojet e kontratave, moshë e të punësuarve, struktura gjinore, struktura nacionale dhe kualifikimi shkollor i të punësuarve në HK-Trainkos - SH. A. është si vijon:

Struktura e të punësuarve në bazë të kategorizimeve të HK-Trainkos-SH.A. më 01 Janar 2019 dhe më 31 Mars 2019				
Totali i të punësuarve	01.01.2019		31.03.2019	
	236		234	
Vlerat	Vlerat në numra		Vlerat në përqindje	
Datat	01.01.2019	31.03.2019	01.01.2019	31.03.2019
Mosha mesatare e punëtorëve	47.16	47.07	%	%
Me marrëdhënie të rregullt pune	236	234	%	%
Me kontratë të pa afatizuar	94	92	39.83 %	39.31 %
Me kontratë të afatizuar	142	142	60.16 %	60.68 %
Meshkuj	211	208	89.40 %	88.88 %
Femra	25	26	10.59 %	11.11 %
Serbë	2	2	0.84 %	0.85 %
Shqiptarë	234	232	99.15 %	99.14 %
Me shkollim fillor	16	16	6.77 %	6.83 %
Me shkollim të mesëm	126	124	53.38 %	52.99 %
Kualifikim profesional	24	24	10.16 %	10.25 %
Me shkollim të lartë	4	5	1.69 %	1.70 %
Me shkollim superior	66	66	27.96 %	28.20 %
Zyrtarët e lartë	4	5	1.69%	2.13%
Departamenti i Transportit të Mallrave	52	51	22.03%	21.79%
Departamenti i Transportit të Udhëtarëve	63	63	26.69%	26.92%
Departamenti i Administratës	42	42	17.79%	17.94%
Departamenti i Financave	9	9	3.81%	3.84 %
Departamenti i Zhvillimit	7	7	2.96%	2.99 %
Departamenti i Prokurimit	4	4	1.69%	1.70%
Kabineti i KE-së	3	3	1.27%	2.28 %
Zyra e Kontrollit, Sigurisë dhe Kualitetit	20	20	8.47%	8.54 %
Zyra për Marrëdhënie me Publikun	2	2	0.84%	0.85 %
Zyra Ligjore	3	3	1.27%	1.28%
Zyra e për Mirëmbajtjen e Mjeteve Lëvizëse	27	25	11.44%	10.68 %

Tabela Nr. 2.1

Sqarim:

- Totali i të punësuarve më 01.01.2019 është 236 të punësuar.
- Totali i të punësuarve më 31.03.2019 është 234 të punësuar.

Vërejtje: Në tabelën e paraqitur më lartë nuk janë përfshirë anëtarët e Bordit të Drejtorëve.

III. TREGUESIT E RAPORTIT FINANCIAR

III.1. Gjendja financiare Janar – Mars 2019

Për periudhën raportuese Janar – Mars 2019, gjendja e pozicioneve të të hyrave dhe shpenzime është siç vijon:

III.2. Të Hyrat

Nga Transporti i mallrave kemi realizuar të hyrat prej 231,246.69€ për periudhën janar - mars 2019. Totali i të hyrave të planifikuara për vitin 2019, është 1,602,630.00€ dhe nga kjo del se kemi realizuar 14.43% nga totali. Të hyrat nga transporti i mallrave eksport/import janë realizuar sipas kategorive që pasojnë: të hyrat nga importi i kemi realizuar përmes vijës kufitare Hani i Elezit janë 92,477.45€ dhe nga eksporti po ashtu përmes vijës kufitare Hani i Elezit kemi realizuar shumën prej 342.41€. Transporti i brendshëm kryesisht është realizuar për “NewCo Ferronikeli” dhe atë në transportin e xehe nga Medveci. Në këtë periudhë nga ky lloj i transportit është realizuar shuma prej 138,426.83€.

Transporti i udhëtarëve për periudhën janar – mars 2019, është realizuar në shumën prej 466,971.61€. Nga të hyrat e faturuara nga Transporti i Kontraktuar janë 316,258.76€, nga të hyrat e planifikuara nga subvencioni për mbulimin e pjesshëm të humbjeve nga trenat tjerë të udhëtarëve kemi realizuar shumën prej 124,999.98€. Burimi i të ardhurave nga biletat është realizuar në shumën prej 25712.87€, shprehur në përqindje më realizimin e të hyrave nga transporti i udhëtarëve kemi arritur shumën e realizimit 37.93%, krahasuar me planifikimet e vitit 2019 – 1,231,000.00€.

Të hyrat nga shërbimet tjera gjatë periudhës janar - mars 2019, kanë arritur shumën prej 6,310.41€. Kjo shumë nëse krahasohet me shumën e buxhetuar për vitin 2019, e cila është 50,000.00€ arrin kuotën prej 12.62%. Kjo e hyrë është realizuar në pozicionin të hyrat nga RIV-i dhe vendosjet – 6,310.41€.

Të hyra tjera të cilat janë realizuar gjatë periudhës janar – mars 2019, kanë arritur shumën prej 17,117.49€. Kjo e hyrë është realizuar në pozicionet siç vijojnë: Të hyrat nga shitja e derivateve për HK-Infrakos Sh. A. – 8,861.99€, te hyrat nga dëmtimi i vagonëve dhe të tjera në vlerë prej 8,255.50€. Buxheti i planifikuar është 90,000.00€, shprehur në përqindjen 19.01 %.

III.3. Shpenzimet

Shpenzimet për periudhën janar – mars 2019, ashtu edhe siç janë buxhetuar janë të klasifikuara në kategoritë që pasojnë.

Totali i kostos së shërbimit për periudhën është 299,853.40€ nga 1,190,705.23€ të planifikuara për vitin 2019 dhe arrijnë kuotën prej 25.18%. Shpenzimet sipas grupimeve në kode të posaçme janë të precizuara në tabelën më poshtë – të hyrat dhe shpenzimet operative për periudhën janar – mars 2019.

Shpenzimet e stafit është kategori tjetër e rëndësishme e cila ka arritur shumën prej 456,109.50€, dhe atë në paga dhe kontribute – 455,087.17€ dhe sigurimi shëndetësor, trajnime dhe shpenzime tjera – 1,022.32€. Në total nëse e krahasojmë shumën e buxhetuar për vitin 2019 – 1,770,000.00€, në këtë kategori kemi arritur kuotën prej 25.77%.

Totali i shpenzimeve operative kap shumën prej 27,006.82€, kjo shumë është 2.54% nga shuma prej 1,064,800.00€ e parashikuar vitin 2019. Edhe kjo kategori e shpenzimeve sipas grupimeve në kode të posaçme është e precizuar në tabelën e më poshtme – të hyrat dhe shpenzimet operative për periudhën janar – mars 2019.

Totali i shpenzimeve administrative ka arritur në kuotën prej 17.87%, konkretisht në shumën prej 32,168.81€. Planifikimi për vitin 2019, i kësaj kategorie është 180,000.00€. Shpenzimet sipas grupimeve në kode të posaçme janë të precizuara në tabelën e mëposhtme – të hyrat dhe shpenzimet operative për periudhën janar – mars 2019.


III.4. Të hyrat dhe shpenzimet operative për periudhën Janar - Mars 2019

	EMËRTIMI	Realizimi Janar-Mars 2019	Buxheti 2019	Diferenca	B/C (%)	Realizimi Janar – Mars 2018
	A	B	C	D	E	F
A	Shitjet					
1	Transporti i mallrave	231,246.69	1,602,630.00	(1,371,383.31)	14.43	131,444.61
2	TU – Ministria e Infrastrukturës	316,258.76	1,031,000.00	(714,741.24)	30.67	0.00
3	TU – Ministria e Zhvillimit Ekonomik	124,999.98	500,000.00	(375,000.02)	25.00	124,999.98
4	TU – Shitja e Biletave	25,712.87	150,000.00	(124,287.13)	17.14	14,092.17
5	Shërbimet tjera	6,310.41	50,000.00	(43,689.59)	12.62	4,126.80
6	Të ardhurat – Dëmtimi i vagonëve	8,255.50	40,000.00	(31,744.50)	20.64	0.00
7	Të hyrat tjera jo operative	8,861.99	50,000.00	(41,138.01)	17.72	10,839.51
I	TOTAL – TË HYRAT	721,646.20	3,423,630.00	(2,701,983.80)	21.08	285,503.07
B	Kostoja e shërbimit/blerjes së materialeve					
1	Derivatet dhe lubrifikantet	153,362.38	616,034.00	(462,671.62)	24.90	110,454.41
2	Energjia elektrike dhe shërbimet tjera komunale	3,917.29	20,000.00	(16,082.71)	19.59	3,317.30
3	Inventar dhe pajisje	-	-	-	0.00	0
4	Material harxhues	-	1,314.23	(1,314.23)	0.00	0.00
5	Pjesë rezervë/mirëmbajtje dhe materiale tjera	6,295.24	45,800.00	(39,504.76)	13.75	3,482.53
6	Qasja në binarë	112,315.12	405,557.00	(293,241.88)	27.69	80,162.99
7	Sigurimi i palëve të treta	1,365.00	6,000.00	(4,635.00)	22.75	1,977.97
8	Tërheqja e trenave dhe qiraja e vagonëve të huaj	13,808.65	40,000.00	(26,191.35)	34.52	1,991.73
9	Shpenzimet e transportit Infrakos	8,789.72	56,000.00	(47,210.28)	15.70	11,204.20
10	Zbritjet e lejuara	-	-	-	0.00	0.00
	TOTAL – KOSTOJA E SHERBIMIT	299,853.40	1,190,705.23	(890,851.83)	25.18	212,591.13
	Fitimi (humbja) bruto	421,792.80	2,232,924.77	(1,811,131.97)	18.89	
	TE ARDHURAT TJERA					
1	Te Ardhura të jashtëzakonshme	-	-	-	0.00	-
2	Zbritjet e mara	849.56	-	849.56	0.00	1,285.60
3	Te ardhura tjera	292.02	800,000.00	(799,707.98)	0.00	-
	TOTAL – Te ardhurat tjera	1,141.58	800,000.00	(798,858.42)	0.14	1,285.60
C	Shpenzimet e stafit			-		
1	Pagat dhe kontributet	455,087.17	1,740,000.00	(1,284,912.83)	26.15	422,869.22
2	Sigurimi shëndetësor, trajnime dhe Shpenzime tjera	1,022.32	30,000.00	(28,977.68)	3.41	1,197.37
	TOTAL - Shpenzimet e stafit	456,109.49	1,770,000.00	(1,313,890.51)	25.77	424,066.59
D	Shpenzimet operative			-		
1	Mirëmbajtje dhe riparime	4,406.33	810,000.00	(805,593.67)	0.54	648.44


2	Sigurimi fizik – total	-	55,000.00	(55,000.00)	0.00	1,977.60
3	Shërbimet tjera	-	500.00	(500.00)	0.00	-
4	Blerja e automjeteve për nevojat e kompanisë	-	20,000.00	(20,000.00)	0.00	-
4	Shpenzimet logjistike	3,107.70	17,000.00	(13,892.30)	18.28	3,698.66
5	Energjia elektrike dhe komunalitë	1,109.35	40,000.00	(38,890.65)	2.77	1,514.09
6	Sigurimi i palëve të treta	550.00	3,000.00	(2,450.00)	18.33	881.27
7	Marketingu	1,053.51	31,000.00	(29,946.49)	3.40	1,545.37
8	Udhëtimet zyrtare	70.00	14,000.00	(13,930.00)	0.50	0.00
9	Telefonat dhe Posta	3,169.65	33,300.00	(30,130.35)	9.52	4,191.58
10	Shërbimet bankare	261.00	1,000.00	(739.00)	26.10	291.95
11	Tatimet	11,652.41	20,000.00	(8,347.59)	58.26	3,067.08
12	Pajisje elektronike	1,626.87	20,000.00	(18,373.13)	8.13	35.10
	TOTAL - Shpenzimet operative	27,006.82	1,064,800.00	(1,037,793.18)	2.54	17,851.14
E	Shpenzimet administrative			-		
1	Inventar dhe pajisje	942.43	20,000.00	(19,057.57)	0.00	1,147.61
2	Konsulenca dhe auditimi i jashtëm	1,271.19	15,000.00	(13,728.81)	8.47	2,076.27
3	Material i zyrës	-	21,000.00	(21,000.00)	0.00	0.00
4	Material sanitar	313.89	9,000.00	(8,686.11)	3.49	447.87
5	Qiraja për objektet	1,650.17	10,000.00	(8,349.83)	16.50	2,283.35
6	Reprezentacioni dhe bufeja	119.55	10,000.00	(9,880.45)	1.20	1,355.71
7	Shpenzimet gjyqësore dhe ndëshkimet	27,458.86	25,000.00	2,458.86	109.84	9,064.42
8	Shpenzimet logjistike	412.72	30,000.00	(29,587.28)	1.38	339.45
9	Kontingjente	-	40,000.00	(40,000.00)	0.00	-
	TOTAL - shpenzimet administrative	32,168.81	180,000.00	(147,831.19)	17.87	16,714.68
	Provizionet e borxheve të këqija	-	-	-	#DIV/0!	0.00
II	TOTAL -SHPENZIMET (B+C+D+E)	815,138.52	4,205,505.23	(3,390,366.71)	19.38	671,223.54
III	Fitimi (Humbja) para zhvlerësimit	(92,350.74)	18,124.77	(110,475.51)	-509.53	-384,434.87
	GRANTET	232,470.09	975,000.00	(742,529.91)	23.84	244,798.38
F	Shpenzimet e zhvlerësimit					
1	Shpenzimet e zhvlerësimit që janë rezultat i granteve	232,470.09	975,000.00	(742,529.91)	23.84	244,798.38
2	Shpenzimet e zhvlerësimit që janë nga buxheti i kompanisë	5,859.30	25,000.00	(19,140.70)	23.44	6,113.97
	TOTAL - shpenzime e zhvlerësimit	238,329.39	1,000,000.00	(761,670.61)	23.83	250,912.35
G	Fitimi (humbja) nga veprimtaria	(98,210.04)	(6,875.23)	(91,334.81)	1428.46	-390,548.84

Tabela Nr. 3.1

Diagrami Nr 3.1. Pjesëmarrja e të hyrave sipas llojit të shërbimit Janar – Mars 2019



Diagrami Nr. 3.2. Pjesëmarrja e shpenzimeve sipas kategorive Janar – Mars 2019



III.5. Gjendja në para të gatshme – Raporti sipas bankës (31.03.2019)

Nr	EMËRTIMI	Saldo 31-03-2019
1	PCB nr. 1114-004229-0001-59	2,028.27
2	PCB (KTh) nr. 1114-004229-0101-50	0.00
3	BKK - PCB (K) nr. 1114-004229-0201-41	0.55
4	BKK - PCB (S) nr. 1114-004229-0301-32	125,000.46
5	BKK - PCB (M) nr. 1114-004229-0401-23	0.91
6	GH-PCB nr. 1114004229040114	0.00
7	BPB	22,013.46
	Totali	149,043.65

Tabela Nr. 3.2

III.6. Transaksionet e realizuara (Janar – Mars) 2019

Në tabelat në vijim janë paraqitur transaksionet e kompanisë në llogaritë rrjedhëse dhe ato në projektet kapitale të financuara nga Buxheti i Kosovës:

Transaksionet e kompanisë në llogaritë rrjedhëse	
Gjendja në llogaritë e kompanisë më 01.01.2019	231.13
Inkasimet e pranuar gjatë muajve janar – mars 2019	335,297.17
Pagesat e kryera gjatë muajve janar – mars 2019	333,500.03
Gjendja në llogaritë e kompanisë më 31.03.2019	2,028.27

Tabela Nr. 3.3

Transaksionet në projektet kapitale të financuara nga Buxheti i Kosovës	
Gjendja në llogaritë e kompanisë më 01.01.2019	54,554.75
Inkasimet e pranuar gjatë muajve janar – mars 2019	0.00
Pagesat e kryera gjatë muajve janar – mars 2019	54,554.20
Gjendja në llogaritë e kompanisë më 31.03.2019	0.55

Tabela Nr. 3.4

BILANCI I GJENDJES		
NP TRAINKOS SH.A	GJENDJA FILLESTARE 01/01/19	GJENDJA PERFU. 31/03/19
Mjetet themelore - vlera neto sipas librave	5,499,876.89	5,304,850.92
Mjetet Qarkulluese	2,820,464.19	3,020,160.91
Stoqet	429,002.01	416,650.06
Paraja	54,938.35	151,733.29
Llogarite e arkëtueshme	1,871,622.66	1,994,683.84
Kërkesa tjera te arkëtueshme	440,107.68	432,300.23
Parapagimet	24,793.49	24,793.49
Total Mjetet Qarkulluese dhe themelore	8,320,341.09	8,325,011.83
Detyrimet afatshkurta	1,898,848.82	2,236,691.087
Llogarite e pagueshme	1,549,822.50	1,717,308.02
Te pagueshme tjera - detyrime	3,140.61	130,438.54
Detyrime tatimore	345,885.71	388,945.31
Llogarite tjera		
Detyrimet afatgjata	3,186,968.59	2,954,498.50
Kapitali	5,305,403.20	5,304,160.66
Fitimi/Humbja e bartur	-2,070,879.52	-2,072,129.20
Fitim/ Humbja e vitit		-98,210.00
Total detyrimet dhe kapitali	8,320,341.09	8,325,011.83

Tabela Nr. 3.5

IV. DEPARTAMENTI I TRANSPORTIT TË UDHËTARËVE

IV.1. Pasqyra e performancës operative

Në këtë pjesë të raportit do të paraqesim performancën gjatë periudhës Janar - Mars 2019, duke krahasuar atë me realizimin e tremujorit të vitit 2018.

Pasqyra e realizimit të transportit të udhëtarëve:

- Biletat e shitura:29,448
- Numri i udhëtarëve:.....29,448

Më poshtë paraqesim tabelën nr. 4.1 ku kemi krahasimin e të dhënave të realizuara gjatë kësaj periudhe me të dhënat e periudhës së njëjtë të vitit të kaluar:

	Realizimi në Vitin 2018	Realizimi në Vitin 2019	Ndryshimi në %
Numri i udhëtarëve	17.786	29.448	65.57 %
Të hyrat nga biletat pa TVSH	13,591.32 €	25,443.38€	87.20 %

Tabela Nr. 4.1

IV.2. Organizimi dhe realizimi i transportit të udhëtarëve

Në tabelën nr. 4.2 janë paraqitur krahasimet e përgjithshme të të dhënave të realizuara në periudhën Janar – Shtator 2018 me periudhën e njëjtë të vitit 2017, rezulton se kemi një ulje të numrit të udhëtarëve në këtë vit.

Përshkrimi - Udhëtarë	Janar – Mars
Realizimi i numrit të udhëtarëve në 2018	17,786
Realizimi i numrit të udhëtarëve në 2019	29,448
Planifikimi i numrit të udhëtarëve në 2019	35,000
Dallimi: Realizim 2019 - 2018	11,662
Dallimi: Realizim - planifikimi 2019	-5,552
Dallimi në %: 2019 - 2018	65.57
Dallimi në %: Realizim - Planifikimi 2019	-15.86

Tabela Nr. 4.2

Siç shihet nga shënimet e paraqitura më lart, sa i përket transportit të udhëtarëve për këtë periudhë kohore kemi pasur një numër të udhëtarëve më të madh krahasuar me vitin e kaluar, me një rritje prej **65.57 %**.

IV.3. Numri i trenave, tren kilometër (T/km) dhe udhëtarë kilometër (U/km)

- Numri i trenave të udhëtarëve për tre mujorë gjithsej kanë qenë **860**.
- Të gjithë trenat e udhëtarëve për këtë tremujorë kanë bërë **46,198** tren / km.
- Për tre mujorin e parë kanë qenë **1,838,080** udhëtarë/kilometër.

IV.4. Vonesat e trenave të udhëtarëve

Prej 860 trena sa kanë operuar në këtë periudhë raportuese, vetëm 0 trena prej tyre kanë shkaktuar këto vonesa siç shihen më poshtë:

Shkaku i vonesave	Minuta	Në përqindje
Lokomotiva HM	0	0.00
Vazhdimi i udhëtimit	0	0.00
Kryqëzimet	0	0.00
Lokomotiva / GM defekt	0	0.00
Lidhja me trenin	0	0.00
Bashkëngjitja e vagonëve. Tërheqja e mjeteve	0	0.00
Doganë + Polici	0	0.00
Pret në garniturë	0	0.00
Aksidente	0	0.00
Të tjera	0	0.00
Total vonesat	0	0.00

Tabela Nr. 4.3

V. DEPARTAMENTI I TRANSPORTIT TË MALLRAVE

V.1. Pasqyra e performancës operative

Në këtë raport nga Departamenti i Transportit të Mallrave janë paraqitur indikatorët fizikë të performancës operative gjatë periudhës tremujore nga 01 Janar 2019 deri më 31 Mars 2019, duke prezantuar realizimin dhe krahasimin me planifikimin që është paraparë për këtë periudhë sipas planit të Biznesit për vitin 2019, si dhe duke krahasuar realizimin e kësaj periudhe me periudhën e njëjtë të vitit paraprak 2018.

Pasqyra e realizimit të transportit të mallrave

Përshkrimi – Sasia e Transportuar	Janar – Mars
Realizimi neto Ton në 2019	69,118.49 Ton
Realizimi Neto Ton në 2019	115,182.06 Ton
Planifikimi Neto Ton në 2019	158,020.00 Ton
Dallimi: Realizim 2019 – Realizim 2018	46,063.57 Ton
Dallimi: Realizim – Planifikim në 2019	- 42,837.94 Ton
Dallimi: Realizim 2019 – Realizim 2018 (%)	166.64 %
Dallimi: Realizim 2019 – Planifikim 2019 (%)	72.89 %

Tabela Nr. 5.1

Siç mund të shihet nga tabela 5.1 në këtë periudhë kohore kemi transportuar për rreth 66.64% më shumë se sa në të njëjtën periudhë raportuese për vitin e kaluar dhe 27.11% më pak se sa sasia e planifikuar për këtë periudhë.

Transporti i mallrave me kontejnerë është i pasqyruar në tabelën 5.2:

Përshkrimi – Numri i Transportuar i kontejnerëve	Janar – Mars 2019
Kontejnerë të plotë – 2019	00,00 copë
Kontejnerë të zbrazët – 2019	00,00 copë

Tabela Nr. 5.2

Sasia e transportuar në Neto ton për periudhën Janar - Mars 2019




Figura Nr. 5.1

Siç mund të shihet nga figura 5.1 në aspektin operativ kemi arritur të realizojmë 73 % nga planifikimi sipas Planit të Biznesit për tremujorin Janar - Mars 2019

IV.2. Shfrytëzimi i Trenave

Në bazë të njoftimit nga Hekurudhat e Maqedonisë si dhe nga klientët, është bërë organizimi dhe planifikimi me kohë për arritjen e dërgesave, nga stacioni kufitar deri në stacionin e shkarkimit. Gjithashtu edhe transporti vendor është realizuar sipas planifikimit.

Import: 34 trena nga 90 të paraparë, ose 37.77 % trena të shfrytëzuar;
 Eksport: 25 trena nga 90 të paraparë, ose 27.77 % trena të shfrytëzuar dhe
 Vendor: 96 trena nga 180 të paraparë, ose 53.33 % trena të shfrytëzuar
Totali: 155 trena nga 360 të paraparë, 45.03 % trena të shfrytëzuar

IV.3. Neto Ton & Neto Ton Kilometër të Transportuar

Nga importi janë realizuar 24,188.17 t ose 62.47 % nga 38,714.90 t, sa kanë qenë të planifikuara. Ndërsa ton kilometër janë 1491154 t/km.

Nga eksporti janë realizuar 196.79 t ose 1.18 % nga 16,592.10 t sa kanë qenë të planifikuara. Ndërsa ton kilometër janë 0 t/km.

Nga transporti vendor janë realizuar 90,797.10 t ose 88.39% ton të realizuar, nga 102,713.00 t neto ton sa kanë qenë të planifikuara për këtë periudhë. Neto ton kilometër janë 2613110 t/km.

Në total gjithsejtë janë realizuar 115,182.06 t ose 72.89% ton të realizuar nga 158,020.00 ton të planifikuar për këtë periudhë.

Neto ton kilometër janë 4,104,264 t/km.

IV.4. Mallrat e transportuara

Kemi transportuar mallra të ndryshme dhe nga 100 % i mallrave të transportuara kemi: Xehe e nikelit 95 %, Plin 1 %, Laminat 1 %, Lesh qelqi 1% dhe mall i përzier 1%




Figura Nr. 5.2

VI. ZYRA E MIRËMBAJTJES SË MJETEVE LËVIZËSE - MML

VI.1. Pasqyra e performancës operative

Në këtë pjesë të raportit do të paraqesim performancën gjatë periudhës 01 janar 2019 – 31 mars 2019, duke krahasuar me realizimin e tremujorin e vitit 2018.

VI.2. Sektori i mirëmbajtjes

Në fushën e sektorit të mirëmbajtjes së: Trenave Motorik, Lokomotivave, Lokomotivave Manovruese, Vagonëve për transportin e udhëtareve si dhe vagonëve për transportin e mallrave gjatë periudhës kohore të raportimit prej 01.01.2019 deri ne 31.03.1019 ne kemi pasur këto rezultate.

Matja e produktivitetit në shfrytëzimin e fuqisë punëtore

Matja e shfrytëzimit të fuqisë punëtore tregon se sa dhe ku shfrytëzohet më tepër fuqia punëtore dhe tregon raportin në mes fuqisë punëtore në dispozicion dhe fuqisë punëtore të shfrytëzuar.

Shërbimi i mirëmbajtjes së Lokomotivave gjatë periudhës janar-mars ka disponua me fuqi pune prej **4500** orë ku:

1607 orë, janë shfrytëzua për riparim apo **36%** e fondit total të orëve;

480 orë, janë shfrytëzua për pune ndihmese dhe dytësore apo **11%** e fondit total të orëve.

Produktiviteti i tërë ka qenë **46%**

Shërbimi i mirëmbajtjes së vagonëve gjatë periudhës janar - mars ka disponua me fuqi pune prej **3165** orë ku:

1040 orë, janë shfrytëzua për riparim apo **33%** e fondit total të orëve

417 orë, janë shfrytëzua për pune ndihmese dhe dytësore apo **13%** e fondit total të orëve

Produktiviteti i tërë ka qenë **46%**

VI.3. Fakturimet për riparimin e vagonëve të huaj për periudhën janar – mars 2019

Vagonët e NewCo Ferronikeli:

- Janar - Mars 2018 është, **0.00 €**,
- Janar - Mars 2019 është **8,135.50 €**

VII. PROJEKTET KAPITALE

Nr	Titulli i Aktivitetit te Prokurimit	Kontrakt uar	Buxheti i zotuar	Vlera e kontrates	Koment
1	Shërbimet e sigurimit fizik te objekteve të Trainkos Sha		55,000 €		Procedurë
2	Furnizim me naftë për nevojat e Trainkos Sha	AQP	1,400,000 €	Porosi	Në zbatim
3	Furnizimi me material hixhienik	Shkurt	5,500 €	4,663.80€	Në zbatim
4	Furnizimi me ujë të pijshëm	Shkurt	4,000 €	2,891.00 €	Në zbatim
5	Sigurimi i palëve të treta	Shkurt	2,000 €	1,610.70 €	Në zbatim
6	Shërbimet mirëmbajtjes së arkave fiskale - DP - 05 për nevojat e Trainkos sh.a		6,500 €		Procedurë
7	Furnizimi me poqa elektrik për lokomotiva		3,635 €		Procedurë
8	Furnizimi me filtra për lokomotiva", numër të prokurimit		5,765 €		Procedurë
9	Furnizimi me pjesë për gjenerator të ngrohjes së lokomotivave		5,000 €		Procedurë
10	Furnizimi me modul për lokomotivën		2,500 €		Procedurë
11	Furnizimi me pjesë për lokomotivën 2710 009		2,550 €		Procedurë
12	Furnizim me material hixhenik		5,000 €		Procedurë
13	Furnizimi me kontejner të plumbit për izolim radioaktiv		2,000 €		Procedurë
14	Furnizimi me Toner		5,000 €		Procedurë
15	Furnizimi me material administrativ		6,000 €		Procedurë
16	Furnizimi dhe instalimi i pompës për furnizim me naftë		6,000 €		Procedurë
17	Furnizimi me kompjuter	Janar	2,000 €	1,888.00 €	Përfunduar
18	Pune shtesë ne projektin Riparimi i tornos për gdhendjen e rrotave të mjeteve lëvizëse	Janar	2,500 €	2.428,35 €	Përfunduar

Tabela Nr. 7.1

VIII. KONTESTET

Gjatë periudhës kohore janar - mars 2019, nga zyra ligjore e ndërmarrjes janë marrë të gjitha veprimet e nevojshme për përfaqësim sa më të mirë në çështjet ligjore pranë të gjitha institucioneve të Republikës së Kosovës. Gjatë periudhës që lamë pas, pranë Gjykatave Themelore i kemi mbajtur **16 (gjashtëmbëdhjetë)** seanca gjyqësore për proceset në të cilat kemi qenë palë në procedurë qoftë në cilësinë e të paditurës apo të paditëses.

Gjatë periudhës që lamë pas ndërmarrja jonë në procedurë ka pasur **65 (gjashtëdhjetë e pesë)** lëndë, prej tyre **5 (pesë)** janë pranuar gjatë kësaj periudhe, ndërsa **10 (dhjetë)** lëndë kanë përfunduar me vendime të formës së prerë.

Prej **10 (dhjetë)** lëndëve të përfunduara gjatë periudhës kohore janar - mars 2019 me vendime të formës së prerë ndërmarrja jonë është obliguar që të paguajë rreth **27,966.45 €** në emër të kompensimeve.

Përkundër faktit se Ndërmarrja në vazhdimësi është ballafaquar me probleme të natyrave të ndryshme rreth ruajtjes së interesave të saj e sidomos sa i përket çështjeve që kanë të bëjnë me kontestet nga kompensimi i dëmeve në të gjitha rastet e aksidenteve të komunikacionit hekurudhor prej të cilave konteste një numër i konsiderueshëm janë trashëguar nga ish - Hekurudhat e Kosovës Sh. A., në një mënyrë ndërmarrja jonë ka arritur që një situatë të tillë ta menaxhojë me sukses.

VIII.1. Rreziqet nga kontestet gjyqësore për vitin 2019

Hekurudhat e Kosovës Trainkos Sh. A. në vitin 2019, pritet të ballafaqohen me **65 (gjashtëdhjetë e pesë)** konteste gjyqësore. Në tabelën më poshtë është pasqyruar numri i kontesteve të hapura dhe kategorizimi i tyre për të cilat mund të përfundohen gjatë vitit 2019:

Nr.	LLOJET E KONTESTEVE	////////
1.	Kontestet e marrëdhënies së punës	17
2.	Kontestet për kompensim të dëmit	26
3.	Kontestet për pagimin e borxhit	5
4.	Kontest nga Konflikti Administrativ	1
5.	Lëndë në procedurë përmbartimore	16
6.	Totali	65

Tabela Nr. 8.1

Pra siç shihet në tabelë, **17 (shtatëmbëdhjetë)** lëndë janë nga kontestet e punës, **26 (njëzet e gjashtë)** lëndë janë nga kontestet e kompensimit të dëmit, **5 (pesë)** lëndë janë nga kontestet për

kthim të borxhit, **1 (një)** lëndë nga kontesti i Konfliktit Administrativ dhe **16 (gjashtëmbëdhjetë)** lëndë nga procedura përmbartimore.

Duhet cekur se gjatë periudhës kohore janar - mars 2019 në Gjykatat e Republikës së Kosovës, kemi mbajtur **16 (gjashtëmbëdhjetë)** seanca gjyqësore, me ç'rast janë përfunduar **10 (dhjetë)** lëndë me vendime të formës së prerë.

Në rast se ndodh që të gjitha këto konteste të përfundohen me vendime të formës së prerë atëherë HK - Trainkos Sh. A rrezikohet që të paguajë në emër të kompensimeve shumën **1.818.610,00 €**, ku duke pas parasysh gjendjen në të cilën gjendet ndërmarrja do të jetë e pa përballueshme.

Vlen të përmendet se rreziku kryesor për HK - Trainkos Sh.A. vjen nga lënda me numër P.nr.173/17, në të cilin rast HK - Infrakos Sh.A. ka parashtruar propozim për përmbartim pranë përmbartuesit privat ku ka kërkuar që HK - Trainkos Sh.A ti përmbartohen në mënyrë të dhunshme shuma në vlerë prej **827.259,27 €**.

Andaj duke pas parasysh gjendjen në të cilën gjendet ndërmarrja jonë, kontestet gjyqësore mbesin si një ndër rreziqet më të mëdha për arsye se janë në numër shumë të madh si dhe me vlera të larta financiare. Në rast të humbjes të ndonjë kontesti kompanisë do ti thellohet kriza financiare edhe më tepër.

IX. DEPARTAMENTI I ZHVILLIMIT TË BIZNESIT

IX.1. Planifikimi dhe Zhvillimi i Biznesit

Nëse e kemi parasysh se planifikimet për sektorin hekurudhorë duhet dhe janë afatgjata atëhere edhe synimet e Qeverisë së Republikës së Kosovës janë që me shfrytëzimin e mundësive që ofrojnë IFN-të dhe Bashkësia Evropiane (BE) dhe me mekanizmat e sajë të bëhet fillimisht investimi në Linjat ekzistuese hekurudhore, pastaj të vazhdohet me Linjat tjera të reja të identifikuar me “Strategjinë Sektoriale dhe Transportin Multimodal 2015 – 2025 dhe Plani i veprimit 5 vjeçar”. Viti 2019 është viti i fillimit të projektit “Rehabilitimi i Linjës së 10-të hekurudhore” Hani i Elezit – Leshak. Me këtë fillon procesi i plotësimit të parakushteve të përcaktuara me “Librin e bardhë” të publikuar për zbatim nga BE-ja në mars 2011. Me këtë synohet krijimi i një zone të mirëfilltë të transportit të përbashkët Evropian duke i eliminuar të gjitha pengesat e mbetura nacionale dhe për të lehtësuar integrimin dhe operimin funksional të transportit hekurudhorë multimodal dhe intermodal.

Edhe gjatë kësaj periudhe raportuese kem zhvilluar aktivitete të ngjeshura në prezantimin e nevojës për një Plan Biznesi afatmesëm (3 apo 5 vjeçar) tek IFN-të dhe mistria/ministritë përkatëse brenda Qeverisë së Kosovës. Kontaktet e vazhdueshme me BERZh-in dhe BEI-në kanë rezultuar me konkretizim të kërkesës sonë për mbështetjen financiare të një Asistence Teknike që TRAINKOS-it do të i mundësonte përgatitjen e Plani të Biznesit paralel me zhvillimet tjera në sektor.

Kontaktet e rregullta me partnerët regjional kanë vazhduar, kjo kryesisht me ata të Republikës së Maqedonisë meqenëse është kanali i vetëm ndërkombëtar në të cilin kemi qasje, dhe kanë qenë të përqendruara në krijimin e mundësive për të rritur transportin, me relaksim të situatës së krizës ekonomik edhe proceseve rehabilituese politike në dhe me Republikën e Greqisë.

Transporti i xehes, lëndës finale dhe thëngjillit për New Co Ferronikeli nga eksporti, importi dhe transporti minierë – punëtori në Drenas po vazhdon sipas planifikimeve të parapara me kontratë me disa vonesa të shkaktuar nga faktorët e jashtëm.

Periudha raportuese përmban vitin e dytë në zbatimin e Marrëveshjes së OShP-së 2018 – 2022.

Për këtë nevojitet një qasje serioze dhe gjetje të formave për të dalë nga gjendja aktuale. Zbatimi i Marrëveshjes së OShP-së 2018 - 2022 është sfidë në vete, me fillimin e zbatimit të kësaj Marrëveshje, viti 2018 nuk ka përmbyll mbulimin e humbjeve nga MI-ja. Obligimi është bartur në vitin 2019 kurse buxheti ka mbetë i njëjtë edhe për tërë vitin 2019. MI për këtë nuk ka siguruar mjetet e nevojshme për mbulimin e humbjeve për tërë vitin dhe është përsëritur problematika e viteve paraprake që sfidon bazën / esencën e sigurimit të likuiditetit të TRAINKOS-it. Nga analiza fillestare shuma e mjeteve të buxhetuara me funksionimin e trenave të aprovuar do të shpenzohet në mes të vitit!

IX.2. Koordinimi i proceseve me ARH-në dhe Institucionet tjera.

Periudha raportuese gjithashtu rezulton me angazhimin e vazhdueshëm në plotësimin e obligimeve në raport me Ministrinë e Infrastrukturës (MI), ARH-në, Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik (MZhE) dhe BERZh.

- ARH, konkretisht Departamenti i Rregullimit të Tregut duke u bazuar në detyrat dhe përgjegjësitë që ka, ka kërkuar dhe është informuar në periudha të rregullta për proceset e diskutimit të Marrëveshjes së OShP-së 2018 – 2022 me Ministrinë e Infrastrukturës;
- Departamenti i Rregullimit të Tregut duke u bazuar në detyrat dhe përgjegjësitë që ka, është furnizuar me statistika zyrtare për transportin e mallrave dhe udhëtarëve në periudha të rregullta mujore;
- Enti Statistikor i Kosovës është furnizuar me statistika zyrtare për transportin e mallrave dhe udhëtarëve në periudha të rregullta raportuese;
- Gjatë periudhës raportuese është bërë koordinimin dhe zhvillimin e aktiviteteve në realizimin e projektit të aprovuar nga Kryemisetria – Muzeu i Bllacës. TRAINKOS-i ka mbështetë projektin me dhënien dhe riaftësimin e tre vagonëve të udhëtarëve dhe një lokomotive;
- Përmes SEETO-s për procesin e monitorimit të Raportit të Progresit janë plotësuar kërkesat sipas pyetësorëve të kërkuar dhe në këtë periudhë kemi rishikuar avancimet në procesin e “masave të buta” për vitin 2019 që janë bazë për zbatim dhe kërkesa për zhvillim dhe avancim.

IX.3. Aktivitet e Marketingut

TRAINKOS SH.A. edhe gjatë këtij tremujori ka vazhduar me përmbushjen e obligimeve të dala nga Plani i Biznesit dhe Plani i Punës i Departamentit të Biznesit për monitorimin dhe vizitat e rregullta drejt klientëve të rregullt duke qenë afër tyre për shqyrtimin e çdo ankese apo kërkesë që kanë në drejtim të kompanisë.

Po ashtu gjatë këtij tremujori janë zhvilluar kontakte dhe takime me klient potencial, me të cilët janë shqyrtuar mundësit e realizimit të transportit me hekurudhë.

Po ashtu gjatë këtij tremujori nuk kanë munguar edhe aktivitet në rrjetet sociale, duke prezantuar shërbimet tona në transportin e mallrave dhe në transportin e udhëtarëve.

IX.4. Raportimi i rregullt vjetor në Asociacionet tjera Hekurudhore

Raportimet e rregullta vjetore në CIT (International Rail Transport Committee) vazhdojnë të bëhen. Fillimi i vitit 2019 rezulton me vazhdimin e ngecjeve në aktivitetet për gjetjen e modalitete për të u anëtarësuar në asociacionet hekurudhore ndërkombëtare. Vlen të përmendet se kjo ende po varet nga politikat shtetërore të cilat po zhvillohen dhe gatishmëria e institucioneve relevante qeveritare për të vepruar në këtë drejtim.

Projekti për mbështetjen e shteteve të Evropës Jug – Lindore i filluar në vitin 2018 e që do të krijoj mundësinë e planifikimeve afatmesme në planet afatmesme deri në vitin 2020 të këtyre shteteve sipas kërkesave që rrjedhin nga BE është në zbatim e sipër. Ky projekt i rëndësishëm planifikohet të zgjatë një vit e gjysmë nëse e kemi parasysh kohën e nevojshme që planifikimet të inkorporohen në planet afatmesme dhe afatgjata për secilin shtet veç e veç. Zbatimi i projektit për TRAINKOS-in do të ishte mbështetje e duhur që së bashku me strategjitë tjera relevante për sektor të përgatitë Strategjinë afatmesme.

X. SFIDAT KRYESORE GJATË PERIUDHËS JANAR – MARS 2019 DHE VEPRIMET PËR TË ARDHMEN

Gjatë periudhës Janar-Mars 2019 si edhe viteve tjera kompania ka vazhduar të ballafaqohet me shumë sfida si në vijim:

Mos respektimi i Ligjit të Hekurudhave të Kosovës Nr. 04 / L-076 për mbulimin e shpenzimeve për OSHP, nënshkrimi i Marrëveshjes për OSHP 2018 – 2022 më 18.04.2018 kufizon linjat në minimum dhe sipas planifikimeve në KASH 2018 – 2021 nuk parashihet ndonjë zhvillim / reformë në këtë lloj të transportit publik:

1. Mungesa e ligjit për sigurinë në komunikacionin hekurudhor;
2. Proceset e shumta gjyqësore të trashëguara nga ish-Hekurudhat e Kosovës;
3. Mos funksionimi i të gjitha linjave hekurudhore;
5. Vonesat në realizimin e projektit “Modernizimi i Linjës së 10-të hekurudhore” si infrastrukturë bazë që bën lidhjen me pjesën tjetër të Evropës (infrastrukturë dhe reforma të sektorit hekurudhorë);
6. Mos zbatimi i bazës ligjore në sektorin e transportit dhe lejimi i konkurrencës jo lojale;
7. Licencimi dhe futja në treg e operatorit hekurudhor privat, pa ndonjë analizë të mirëfilltë të tregut nga ana e institucioneve relevante;
8. Gjendja jo e mirë e mjeteve lëvizëse për shkak të vjetërisë së tyre dhe kostoja e lartë investuese;
9. Mungesa e një “Master Plani afatmesëm” për TRAINKOS-in;
10. Neglizhenca e institucioneve relevante të cilat veprojnë në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës në inkorporimin e operatorit shtetërorë në planifikimet strategjike për zhvillim industrial të vendit;
11. Moshë mesatare e lartë e personelit ekzekutiv.

Duke pasur parasysh që sfidat e lartcekura janë të natyrave të ndryshme dhe kërkojnë përkrahje edhe nga shumë institucione relevante, kompania është munduar në vazhdimësi që këto sfida/probleme t’i paraqes dhe të kërkojë zgjidhje/mbështetje, mirëpo marr parasysh karakterin e tyre ka qenë e pamundur arritja e rezultateve pozitive duke rezultuar edhe me mos përmirësimin e përgjithshëm të kompanisë.

Edhe në vazhdim në mbetemi të përkushtuar dhe do të insistojmë që të gjitha këto probleme të trajtohen nga institucionet dhe faktorët tjerë relevant në mënyrë që të marrim zgjidhjen e duhur, me qëllim të zhvillimit të ndërmarrjes si aset shtetëror.

Për këto sfida të precizuara më lart përgjegjësit në kompaninë Hekurudhat e Kosovës - TRAINKOS Sh. A. sipas planifikimeve mbesin të përkushtuar në angazhimin maksimal në arritjen e realizimit të objektivave.

Fushë Kosovë,
Prill 2019

**Gelora Shala**
Kryeshef Ekzekutiv